

Msc. Valdón Bytyçi

(Studiues-politolog)

Bio e shkurtër

Valdon Bytyçi është profesionist nga Kosova me përvojë të gjerë në fushën e drejtësisë, drejtësisë tranzicionale, të drejtave të njeriut, qeverisjes lokale, zhvillimit të komuniteteve dhe menaxhimit të projekteve. Aktualisht shërben si Zyrtar i Lartë për Drejtësi Tranzicionale në Ministrinë e Drejtësisë së Kosovës, ku angazhohet në hartimin dhe zbatimin e politikave, strategjive dhe dokumenteve ligjore në këtë fushë, si dhe në bashkëpunimin me institucionet, shoqërinë civile dhe organizatat ndërkombëtare.

Gjatë karrierës së tij ka punuar edhe në Ministrinë e Diasporës dhe Investimeve Strategjike, Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, Universitetin e Prishtinës dhe organizata të shoqërisë civile, duke përfshirë role në menaxhim projektësh, koordinim, komunikim publik dhe zhvillim të të rinjve.

Bytyçi ka përfunduar studimet në Shkenca Politike, Kriminologji dhe Drejtësi, ndërsa ka ndjekur një sërë programesh profesionale në qeverisje lokale, integrim evropian, drejtësi tranzicionale, zhvillim njerëzor dhe lidërsip. Është gjithashtu autor i artikujve dhe pjesëmarrës në konferenca shkencore, me fokus kryesisht në drejtësinë tranzicionale, të drejtat e njeriut, paqëndërtimin dhe zhvillimin e shoqërive pas konfliktit.

Titulli: Prishja e marrëdhënieve Tito Stalin (1948) dhe ndikimi në mbylljen e kufirit Kosovë-Shqipëri.

Abstrakt

Marrëdhëniet ndërmjet Jugosllavisë dhe Shqipërisë kanë qenë të ndikuara dhe të orientuara në varësi të konstelacioneve gjeostrategjike ndërkombëtare. Ndryshimet e vazhdueshme në qasje dhe ideologji nga fuqitë fituese të Luftës së Dytë Botërore përcaktuan politikën edhe në nivele më lokale, siç ishte rasti i marrëdhënieve ndërmjet Shqipërisë dhe Jugosllavisë.

Përpyjekjet për dominim dhe forcim të ndikimit politik sollën ndërhyrje të thella dhe shpeshherë brutale në ndryshimin e kursit politik ndërmjet vendeve fqinje. Deri në vitin 1948, marrëdhëniet ndërmjet Jugosllavisë dhe Shqipërisë u zgjeruan në atë masë sa që u konsiderua edhe mundësia që Shqipëria të bëhej republika e shtatë e Federatës Jugosllave.

Megjithatë, refuzimi i prerë i udhëheqjes jugosllave ndaj Informbyros bëri që Stalini të ndryshonte rrënjësisht qasjen ndaj Jugosllavisë. Përkatesisht, nga një qasje që synonte përfshirjen e Shqipërisë në orbitën jugosllave, u kalua në mbështetjen, sigurimin dhe forcimin e shtetit shqiptar si një aleat besnik i ideologjisë socialiste sovjetike.

Qasja metodologjike e këtij hulumtimi bazohet në rishikimin e literaturës ekzistuese shkencore dhe në përdorimin e metodave kualitative, siç janë intervistat.

Trajtimi i tematikës së ndikimit në mbylljen e kufirit Kosovë–Shqipëri pas vitit 1948 përqendrohet në masat represive të ndërmarra ndaj personave të dyshuar në Kosovë (por edhe në Shqipëri), të cilët konsideroheshin përgjegjës për përpjekje destabilizuese ndaj Jugosllavisë, me qëllim përfundimtar bashkimit të Kosovës me Shqipërinë. Njëkohësisht, një pjesë e rëndësishme e udhëheqjes komuniste në Shqipëri mbështeste ide të ngjashme në drejtim të kundërt.

Kjo fushatë, e nisur menjëherë pas përfundimit të luftës, vazhdoi në forma të ndryshme deri edhe pas vitit 1966, duke ndikuar ndjeshëm në izolimin e kufirit dhe në ndërprerjen e kontakteve ndërshtetërore.

Fjalët kyçe: *Informbyro, gjeostrategji, Shqipëri, Jugosllavi, kufiri, bashkimi*